



Viti i VIII-të i Botimit, Nr.2,
Dhjetor 2017

POLITIKA EURO-MESDHETARE NDAJ MIGRACIONIT

Erjon Marku*; Alketa Marku**

*Instituti i Studimeve Europiane, Universiteti i Tiranës

**Departamenti i Shkencave Politiko-Administrative, Albanian University

Adresë kontakti: *markuerjon@gmail.com*

Përmbledhje

Pas përfundimit të bipolarizimit dhe me hapjen e kufijve, gjithnjë e më shumë persona migruan nga Lindja në Perëndim. Arsytet janë në shumicën e rasteve të diktuar nga arsyet ekonomike, demografike, politike dhe të tjera. Por mbi të gjitha, hapja e kufijve bën që Europa të bëhet më e vetëdijshme për dy modelet demografike që paraqiten në të dy anët e Mesdheut. Vende europiane që tradicionalisht kanë qenë të njohura si vende të emigracionit, në një kohë të shkurtër u shndërruan në vende imigrimi, kjo mbi të gjitha për pozicionin e tyre gjeografik. Ky fenomen çoi kështu në shfaqjen e një ndjenje të përgjithshme të frikës, kërcënimit dhe pakënaqësisë. Reagimi i BE-së, i pasuar nga marrëveshjet e bashkëpunimit për të luftuar fenomenin e emigracionit të paligjshëm, politikën dhe orientimet strategjike ndaj migracionit, do të jenë objekt i këtij punimi.

Fjalë çelës: *migracioni, Mesdheu, politika, institucione.*

THE EURO-MEDITERRANEAN POLICY ON MIGRATION

Abstract

After the end of bipolarism and the opening of borders, more and more people migrated from East to West. The reasons are in most cases dictated by economic, demographic, political and other reasons. But above all, opening the boundaries makes Europe become more aware of the two demographic patterns that appear on both sides of the Mediterranean. European countries that have traditionally been known as immigration states have been transformed into host countries in a short time, above all for their geographic position. This phenomenon led to the emergence of a general sense of fear, threat and dissatisfaction. The EU response followed by cooperation agreements to combat the phenomenon of illegal immigration, policies and strategic orientations towards migration, will be the subject of this paper.

Key words: *migration, the Mediterranean, politics, institutions.*

1. HYRJE

Kohët e fundit, koncepti i “sistemit të migracionit” është trajtuar nga shumë autorë. Sipas Kritz dhe Zlotnik (1), një sistem migrimi përbëhet nga një grup vendesh mes të cilëve ka një shkëmbim relativisht intensiv dhe ku mund të dallohen shkëmbime të tjera që kanë të bëjnë me lidhjet historike, politike, kulturore, ekonomike dhe teknologjike. Edhe pse ende në fillimet e saj në krahasim me zonat e tjera, është i mundur dallimi i zonës mesdhetare si një sistem migrator. Nga pikëpamja ekonomike, *Konferenca Euro-Mesdhetare e Barcelonës*, e mbajtur në 1995, shënoi hapin e parë drejt krijimit të zonës së integruar mesdhetare. Shtetet anëtare nënshkruese të *Aktit Final* mund të konsiderohen si “Mesdheu i ri.” Në aspektin e shtrirjes territoriale të partneritetit, ekziston një zonë tradicionalisht e njohur për migrime, bregu juglindor, dhe një zonë tradicionalisht destinacion i migrimeve, vendet e BE-së. Lëvizjet nga Mesdheu Jugor ndjekin gjithashtu edhe një rrugë tjetër që të çon drejt vendeve të gadishullit Arabik. Nga ana tjetër, kohët e fundit, vendet e bregut juglindor, dhe në veçanti Turqia, janë kthyer në një zonë kalimi, pothuajse të detyruar, për zhvendosjet që zhvillohen nga Lindja e Mesme drejt Europës. Kështu, në varësi të fenomenit që merret në studim, duket i përshtatshëm për të zgjeruar apo ngushtuar kufijtë e «Mesdheut», në mënyrë që të kuptohen më mirë ndërveprimet mes zonave të ndryshme fqinje (2). Pellgu mesdhetar nga pikëpamja demografike është shumë heterogjen: rajone dhe vende të ndryshme dallojnë për zhvillimet jo të njëjta që kanë arritur përgjatë rrugës së gjatë të tranzicionit demografik. Normat e rritjes së popullsisë në këtë zonë kanë paraqitur përgjatë viteve 1950-1980 vlera të jashtëzakonshme. Në periudhën referuese, vendet e bregut jugor përfunduan fazën e parë të tranzicionit demografik, ku u dëshmuar një rënie e shpejtë e koeficientëve të vdekshmërisë (mortalitetit sidomos të mitur); megjithatë, ndërsa disa vende, të tilla si Tunizia dhe Turqia, duket se kanë zgjedhur rrugën e shpejtë që çon deri në fund të fazës së dytë të tranzicionit, në të cilën vihet re një riekulibër i raportit të lindshmërisë dhe vdekshmërisë, ndërsa vende të tjera kanë hasur vështirësi të konsiderueshme në avancimin e këtij procesi (2). Duke filluar nga vitet shtatëdhjetë politikën mbi emigracionin janë bërë gjithnjë e më të ngjashme në të gjitha vendet e Evropës Perëndimore, pavarësisht spektrit politik: kufizime të rrepta mbi emigracionin, nxitja e kthimit vullnetar në vendet e tyre, integrimi i emigrantëve të përhershëm dhe atyre të brezit të dytë, dhe, me përjashtim të Francës, liberalizimin e ligjeve që lidhen me natyralizimin. Shumica e vendeve aplikojnë ligje të cilat u japin më shumë të drejta emigrantëve rezident, si dhe përkujdesje për sa i përket strehimit dhe arsimit, në mënyrë që të inkurajojnë integrimin (3). Siç kuptohet dhe nga sa u tha më lart, për një kohë të gjatë nuk mund të flitej për një politikë të përbashkët evropiane mbi migracionin apo emigracionin, por gjithsesi, ekzistonte një konvergjencë mes masave të marra në baza nacionale për të njëjtin qëllim. Në fakt, mendohej se diferenca gjithnjë e më rritje e pasurisë dhe standardit të jetesës mes dy palëve ishte një nga faktorët e fluksit migrator. Politikën mesdhetare duket se orientohen në atë drejtim, pasi mbështeten dhe aplikojnë një liberalizim progresiv të tregtisë dhe kapitalit nën supozimin se hendeku ekonomik midis dy zonave mund të reduktohet në dy mënyra: me zhvillimin e tregtisë ndërkombëtare, apo me lëvizjen e faktorëve të prodhimit.

Në të dyja rastet kjo do të prodhojë, sipas mbështetësve të kësaj teorie, një shtim të prodhimit, dhe për këtë arsye do të zvogëlojë migrimin e punës pasi ajo do të zvogëlojë nevojën. Të tjerë kritikojnë këtë qasje duke argumentuar që në një periudhë afatshkurtër do të ndodhë e kundërta, pasi liberalizimi do të japë një shtysë drejt migrimit (4). Ndaj është e nevojshme të krijohen

hapësira rajonale që mund të kontribuojnë në menaxhimin politik dhe shoqëror të fenomeneve politike dhe sociale, si p.sh. migrimi (5). Pikërisht në këtë drejtim Bashkimi Evropian ka lëvizur me politikat e tij, veçanërisht që nga viti 1995 e në vijim.

2. Fenomeni i migrimit në pellgun e Mesdheut dhe Politikat e BE-së

Pas përfundimit të bipolarizimit dhe me hapjen e kufijve, gjithnjë e më shumë persona migruan nga Lindja në Perëndim. Arsyet janë në shumicën e rasteve të diktuar nga arsyet ekonomike, demografike, politike dhe të tjera. Por mbi të gjitha, hapja e kufijve bën që Europa të bëhet më e vetëdijshme për dy modelet demografike që paraqiten në të dy anët e Mesdheut. Ndërkohë që shtetet anëtare kanë pësuar një deficit demografik të fortë dhe kjo ka një ndikim të madh në fuqinë punëtore, vendet e bregut jugor pritet të kenë një dyfishim për vitin 2030 (6). Mes viteve 2005 dhe 2020, BE do të ketë një reduktim të popullsisë me më shumë se 5 milionë njerëz (-1.5 për qind), ndërsa Afrika e Veriut do të shënojë një rritje prej më shumë se 45 milionë (23.7 për qind). Vendet evropiane më të prekura nga rënia e popullsisë do të jenë Italia, Spanja dhe Gjermania.

Vende evropiane që tradicionalisht kanë qenë të njohura si vende të emigracionit, si Spanja, Portugalia dhe natyrisht Italia, në një kohë të shkurtër u kthyen në vende imigrimi. Kjo ndodh mbi të gjitha për pozicionin e tyre gjeografik, pasi kufijtë e Evropës janë më të ekspozuar sesa shtetet e tjera, duke bërë që ato të konsiderohen si vende tranzit për migrimin (7). Kjo shpesh ka çuar në shfaqjen e një ndjenje të përgjithshme të frikës, kërcënimit dhe pakënaqësisë ndaj këtij fenomeni. Reagimi i BE-së ishte marrja e masave të sigurisë, e pasuar kjo nga një marrëveshje bashkëpunimi për të luftuar fenomenin e emigracionit të paligjshëm, e që përfshinte gjithashtu nënshkrimin e marrëveshjeve të para të ripranimit të personave të dëbuar, *Marrëveshjen e Shengenit* të vitit 1985. Kjo është përpjekja e parë për të harmonizuar politikën evropiane të migracionit dhe karakterizohet nga një grup shumë i gjerë rregullash që përcaktojnë objektivat dhe modalitetet e bashkëpunimit. Në veçanti, *Konventa për Zbatimin e Marrëveshjes së Shengenit* parashikon krijimin e një strukture të përhershme të përbërë nga një sekretariat dhe një komitet ekzekutiv me nga një përfaqësues për secilin shtet pjesëmarrës, të cilët bazojnë punën e tyre në grupe pune ad hoc. Në praktikë, pjesëmarrësit e Shengenit vendosën një bashkëpunim ndërqeveritar që synonte heqjen e kontrolleve të policisë mbi personat dhe mallrat në kufijtë e brendshëm, forcimin e kontrolleve në kufijtë e jashtëm dhe intensifikimin e kontrolleve të sigurisë brenda hapësirës së lëvizjes së lirë. Marrëveshja Shengen gjithashtu lejoi krijimin e *Sistemit të Informacionit Shengen (SiS)* (8), i cili lejon shkëmbimin e të dhënave mbi identitetin e personave, si dhe përshkrimin e objekteve të kërkuara ndërmjet autoriteteve të shteteve anëtare. Politika e Komunitetit mbi imigracionin në këtë fazë të parë ishte pothuajse tërësisht e fokusuar në kontrollin e kufijve të jashtëm, të vizave dhe sanksioneve për veprat penale që lidhen me imigracionin e paligjshëm. Prioritetet e veprimit përcaktoheshin nga ministrat e brendshëm dhe forcat e policisë së shteteve anëtare pa përfshirjen reale të vendeve të origjinës së emigrantëve.

Megjithatë, korniza për bashkëpunim në luftën kundër emigracionit fillon të ndryshojë dhe të pasurohet, kryesisht me shtetet e Mesdheut Perëndimor, falë dialogut politik 5 + 5. Deri atëherë vendet jugore kishin vetëm marrëdhënie dypalëshe, të cilat ndryshuan kur Franca në vitin 1990 nisi në Romë, për të siguruar ndër të tjera një koordinim të mjaftueshëm në luftën kundër emigracionit të paligjshëm. Vendet që morën pjesë, ishin 5 vende evropiane mesdhetare dhe 5 vende të bregut

jugor. Kjo iniciativë kishte për qëllim ndjekjen e bashkëpunimit ndërinstitucional për çështjet e përbashkëta të migracionit përmes krijimit të një politike migruese të përcaktuar me marrëveshje të përbashkëta midis pjesëmarrësve. Iniciativa, megjithatë, nuk rezultoi shumë e kënaqshme, gjithmonë nëse u referohemi synimeve përtej komunitetit. Vetëm në vitet nëntëdhjetë me hyrjen në fuqi të *Traktatit të Mastroihti*, kemi krijimin e institucioneve të Komunitetit. Politika e imigracionit është një nga nëntë fushat e bashkëpunimit të së ashtuquajturës *Shtylla e Tretë* (9). Por do të jetë Traktati i Amsterdimit i cili do të sjellë ndryshimin më të rëndësishëm, nën nxitjen e partneritetit euro-mesdhetar që ishte iniciuar disa vite më parë, përmes komunitarizimit të çështjes ku u vendos si një prej qëllimeve edhe “krijimi i një hapësire të përbashkët lirie, sigurie dhe drejtësie. BE e pranoi nevojën për një qasje të përbashkët për menaxhimin e emigracionit në Këshillin European në Tampere në tetor 1999. Në atë rast, krerët e shteteve dhe të qeverive përcaktuan një politikë të përbashkët të imigracionit duke identifikuar katër pikat kryesore: partneriteti me vendet e origjinës, sistemi i mbrojtjes së përbashkët për azilkërkuesit, trajtimi i drejtë i shtetasve të vendeve të treta, menaxhimi efikas dhe flukset e migracionit të koordinuara. Në të vërtetë, dimension i jashtëm i fushës së Drejtësisë dhe i Punëve të Brendshme përmendet në mënyrë eksplicite dhe krijon kështu një lidhje midis PESC dhe sigurisë së brendshme të Bashkimit. Është e rëndësishme, sepse ajo shënon kalimin nga një qasje mbrojtëse dhe kufizuese ndaj migrimit në një hapje më të madhe dhe ka hedhur themelet për bashkëpunimin gjyqësor në çështjet penale, si dhe krijimin e Eurojus. I ka caktuar gjithashtu Europolit një rol kyç në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore, në bashkëpunim me vendet e treta.

Brenda pak vitesh, megjithatë, ky vizion ndryshoi rrënjësisht. Pas ngjarjeve të papritura dhe tronditëse të fillimit të shekullit të ri, rritja e flukseve migratore nga Evropa Lindore dhe Mesdheu çoi në një rishikim të thellë të politikës së përbashkët të imigracionit.

Në dhjetor të 2005, Këshilli miratoi të ashtuquajturën qasje globale në fushën e migrimit, një dimension global i veprimeve të BE-së që të synojë përfshirjen e vendeve të origjinës dhe tranzitit dhe shkaqet rrënjësore të migrimit, duke nxitur sinergjitë midis migracionit dhe zhvillimit (10). U kalua nga një politikë e orientuar drejt zhvillimit më të madh dhe më pak migrim, në një politikë që synon një imigracion më të mirë për një zhvillim më të mirë. Ky ndryshim konfirmohet dhe nga Komunikata e Komisionit në të cilën fenomeni i emigracionit trajtohet si një realitet konkret i një Europe të hapur dhe pa kufij të brendshëm tashmë, ku çdo shtet anëtar i vetëm, në sinergji me institucionet, duhet të “ndërgjegjësohet” për të siguruar një menaxhim gjithnjë e më efektiv të migrameve. Rikonfirmohet se emigracioni mund të jetë një mundësi, e cila do të shërbejë si një faktor shkëmbimi kulturor, njerëzor, social dhe ekonomik. Pas Komunikimit të Komisionit në 2008, nisi një nismë franceze për emigracionin, *Pakti Evropian mbi Imigracionin dhe Azilin* i cili paraqet një hap të ri përpara në politikën evropiane dhe që do të jetë subjekt i një debati të gjerë me rastin e mbledhjes së Këshillit më 24 dhe 25 korrik të po atij viti.

Për herë të parë, një dokument zyrtar i BE thotë se imigrimi është gjithashtu një përfitim për Evropën dhe se një mbyllje e plotë e Evropës ndaj fenomenit të emigracionit është e rrezikshme. Ai gjithashtu merret me çështjen e emigracionit të paligjshëm dhe nevojën për një harmonizim homogjen dhe konkret. Imigracioni mund të jetë një mundësi për zhvillim ndërkulturor, humanitar dhe ekonomik në një Evropë ku popullsia aktive po bëhet më e vogël dhe normat e lindjeve janë shumë të ulëta. Përveç kësaj, Këshilli ripohon bindjen se çështjet e migracionit janë një

pjesë integrale e marrëdhënieve të jashtme të Bashkimit dhe që, rrjedhimisht, menaxhimi i strukturuar i migracionit të ligjshëm dhe një luftë efektive kundër imigracionit të paligjshëm duhet të konsiderohen si instrumente për të nxitur sinergjitë mes migrimit dhe zhvillimit. Këshilli, i vetëdijshëm për progresin e rëndësishëm të bërë nga shtetet anëtare në harmonizimin e politikave të migracionit, beson në nevojën për “hapa të mëtejshëm përpara”. Pakti u pasua pastaj nga Programi i Stokholmit i vitit 2009 i cili rifilloi objektivat e përcaktuara në Paketë dhe ato të *Programit paraprak të Hagës* të vitit 2004 dhe thelloi më tej idenë e një bashkëpunimi të bazuar në *Hapësirën e Lirisë, Sigurisë dhe Drejtësisë* duke e rregulluar atë në një program pune pesëvjeçar (11). Traktati i Lisbonës, i cili hyri në fuqi në dhjetor të vitit 2009, solli procedurën e bashkëvendimmarrjes, si dhe votimin me shumicë të cilësuar përsa i përket emigracionit të ligjshëm, si dhe një bazë të re ligjore për promovimin e masave të integritetit. Aktualisht, procedura e zakonshme ligjore zbatohet si për emigracionin e paligjshëm ashtu edhe për politikën ligjore të emigracionit të ligjshëm, gjë që e bën parlamentin si bashkëligjvënës dhe në një plan barazie me Këshillin. Duhet të theksohet, megjithatë, se në rastin e një fluksi të papritur të shtetasve të vendeve të treta, masat e përkohshme merren vetëm nga Këshilli, pas konsultimit me parlamentin (Neni 78 (3) TFEU). Traktati i Lisbonës gjithashtu përcakton se kompetencat e Bashkimit në fushën në fjalë ndahen me shtetet anëtare, veçanërisht përsa i përket numrit të emigrantëve të autorizuar për të hyrë në një Shtet Anëtar për qëllime punësimi (Neni 79 (5), TFEU). Së fundi, Gjykata e Drejtësisë tani ka kompetencë të plotë në fushën e emigracionit dhe azilit (12).

3. Orientimet strategjike të qershorit 2014

Programi i Stokholmit, i miratuar në dhjetor 2009 për të zëvendësuar programet shumëvjeçare të Tampere (1999) dhe Hagës (2004), u përfundua në dhjetor 2014. Në mars 2014, Komisioni publikoi një komunikatë të re të titulluar “Një Evropë e hapur dhe e sigurt: si ta realizojmë”. Në përputhje me nenin 68 të TFBE, Këshilli Evropian përcaktoi në konkluzionet e tij të 26 dhe 27 qershorit 2014 “*Udhëzimet Strategjike për Programimin Legjislativ dhe Operacional në kuadër të krijimit të Zonës së Lirisë, Sigurisë dhe Drejtësisë*” për periudhën 2014-2020. Nuk bëhet më fjalë për një program, por për orientime të fokusuara në përthithjen, zbatimin dhe konsolidimin e instrumenteve dhe masave ligjore ekzistuese. Nënvizohet nevoja për një përqasje gjithëpërfshirëse në fushën e migracionit, duke përdorur migrimin legal sa më mirë që të jetë e mundur, duke siguruar mbrojtje për ata që kanë nevojë, duke luftuar migracionin e parregullt dhe duke menaxhuar në mënyrë efektive kufijtë (12).

Në bazë të propozimit të paraqitur nga Komisioni Evropian (Plani i Veprimit në 10 pika), më 23 prill 2015, shtetet anëtare u angazhuan (shih Deklaratën e Këshillit Evropian) të miratojnë me shpejtësi masat për të shpëtuar jetë njerëzish si dhe për të intensifikuar veprimet e Bashkimit në fushën e migracionit. Pas disa ditësh më 29 prill, u miratua një rezolutë e parlamentit evropian.

Më 13 maj 2015, Komisioni publikoi agjendën evropiane të migracionit. Agjenda propozon masa të menjëhershme për të trajtuar situatën e krizës në Mesdhe dhe përshkruan nisma që duhen ndërmarrë në vitet e ardhshme për të menaxhuar më mirë migracionin në të gjitha aspektet e tij. Në një periudhë afatmesme dhe afatgjatë, Komisioni propozon udhëzime në katër drejtime: uljen e stimuljeve për migracionin e parregullt; menaxhimin e kufijve për të kursyer jetë njerëzore dhe garantuar sigurinë; zhvillimi i një politike kundrejt azilit; dhe së fundi, për të zbatuar një politikë të

re mbi migracionin e ligjshëm, duke vendosur prioritetet e reja mbi politikën e integritetit dhe duke optimizuar përfitimet e politikës së migrimit për njerëzit dhe vendet e origjinës (12).

Agjenda gjithashtu paraqiti idenë e krijimit të një sistemi të zhvendosjes dhe risistemimit në nivel evropian, duke njoftuar qasjen e bazuar në “pikat e krizës” (ku agjencitë përkatëse të BE-së punojnë në terren në bashkëpunim me shtetet anëtare për të kryer me shpejtësi identifikimin e gjurmëve të gishtave, regjistrimin dhe marrjen e gjurmëve të gishtërinjve për emigrantët) dhe propozon një operacion të mundshëm të PSDC në Mesdhe, me qëllim shpërbërjen e rrjeteve të trafikimit dhe ndalimin e trafikimit të qenieve njerëzore. Më 6 prill 2016, Komisioni publikoi udhëzimet e tij mbi migracionin e ligjshëm, në veçanti në një komunikatë të titulluar «Reformimi i Sistemit të Përbashkët Evropian të Azilit dhe Forcimi i Qasjes Ligjore në Evropë». Ekzistojnë katër fusha kryesore të veprimit për politikën e migracionit: rishikimi i Direktivës së Kartonit Blu, tërheqja e sipërmarrësve të rinj në Bashkimin Evropian, miratimi i një modeli më koherent dhe më efektiv i menaxhimit të migracionit të ligjshëm në nivel të BE-së, në veçanti përmes një vlerësimi të kuadrit ekzistues dhe për të forcuar bashkëpunimin me vendet kryesore të origjinës (12).

Që nga hyrja në fuqi e Traktatit të Lisbonës, Parlamenti është angazhuar aktivisht, në cilësinë e bashkëligjvënësit, në miratimin e legjislacionit të ri mbi imigracionin legal dhe ilegal. Më 17 dhjetor 2014 Parlamenti miratoi një rezolutë mbi situatën në Mesdhe dhe nevojën për një përqasje gjithëpërfshirëse të BE-së për migracionin, rezolutë që i jep Komisionit përsa i përket Lirive Civile, Drejtësisë dhe Punëve të Brendshme, mandatin për të përgatitur një raport me iniciativën e tij. Raporti, i shoqëruar nga 8 dokumente pune që i dedikohen aspekteve të ndryshme në fushën e politikës së azilit dhe migracionit si dhe nga opinionet e komisioneve të ndryshme parlamentare, u miratua në mbledhjen plenare më 12 prill 2016.

Përfundime

Megjithëse fluksi migrator tani vihet re dukshëm në Mesdhe, me një fluks të vazhdueshëm si nga bregu jugor në atë verior, është gjithashtu e vërtetë që disa nga vendet e mëparshme janë bërë progresivisht vende të destinacionit falë rritjes së standardit të jetesës dhe kushteve social-ekonomike, por edhe nga bashkëpunimi i tyre i gjatë me BE-në. Në raste të tjera, disa prej këtyre shteteve janë bërë qendër e lëvizjeve migratore nga kontinenti afrikan në atë evropian, siç është rasti i Libisë (13). Të përballur me paralizën e mekanizmit multilateral, autoritetet qeveritare të disa shteteve evropiane i dhanë një shtysë të re iniciativave bilaterale duke iniciuar negociatat me partnerët e Mesdheut në fushën e migracionit, ripranimit dhe azilit. Përveç kësaj, për të nxitur më tej shtetet për të aplikuar dhe zbatuar mbi sa kanë rënë dakord, disa vende evropiane as nuk hezituan të përfshijnë edhe stimuj ekonomik të llojeve të ndryshme.

Politika evropiane e fqinjësisë e vitit 2004 konfirmoi rëndësinë gjithnjë e në rritje që çështja e sigurisë ka marrë duke përfshirë dhe politikën e imigracionit brenda saj, por megjithatë ajo pati meritën e ofrimit të një vizioni të ri të politikave që duhen ndërmarrë në menaxhimin e migracionit. Bazuar në dokumentin mbi *Strategjinë e Sigurisë Evropiane* krijohet një ndërlidhje mes sigurisë, zhvillimit dhe nevojës që ka BE-ja për të patur fqinjësi të sigurt (14).

Prandaj, BE-ja synon të orientojë gjithnjë e më shumë ndihmën e saj financiare dhe teknike, si dhe dhënien e përfitimeve tregtare, gjithashtu në bazë të disponueshmërisë individuale të vendeve të treta për të bashkëpunuar në menaxhimin e flukseve të migracionit. Planet e veprimit mund të

shihen si harta që identifikojnë prioritetet dhe angazhimet për reformat ekonomike dhe politike, si dhe rekomandimet dhe veprimet në marrëdhëniet midis BE-së dhe vendit të tretë për të arritur prioritetet e dakorduara. Bazuar në zgjedhjen e bërë dhe angazhimin e treguar në luftën kundër emigracionit të paligjshëm, vendet do të kenë qasje më të madhe ose më të vogël në ndihma ekonomike edhe pse, siç mendojnë disa, ajo kurrë nuk do të bëhet prioritet i atyre vendeve. U realizua kështu “outsourcing” i politikës në fushën e drejtësisë dhe punëve të brendshme si dhe institucionalizimi i saj në kuadrin e marrëdhënieve euro-mesdhetare. Lufta ndaj terrorizmit dhe migracionit të paligjshëm u zhvendos kështu gradualisht jashtë BE-së duke u orientuar drejt vendeve fqinje (15).

Prandaj është e nevojshme këmbëngulja mbi nevojën për të trajtuar imigracionin në zonën euro-mesdhetare duke adoptuar një qasje të gjerë, strukturore dhe të integruar që synon arritjen e një balancë midis politikave të kontrollit dhe menaxhimit të rregullt të flukseve migratore, duke i kushtuar vëmendje të veçantë imigracionit për arsye pune dhe politikave të bashkëpunimit dhe zhvillimit të vendeve të rajonit. Qëllimi evropian për të siguruar prosperitet afatgjatë dhe siguri për Mesdheun, si një mjet tjetër për të frenuar flukset e migracionit është gjithashtu i vështirë të arrihet pa miratimin e reformave politike që përfshijnë vendet e Mesdheut.

Referenca

1. Kritz, M.M., Lim L.L. and Zlotnik, H. (1992) *International Migration Systems: A Global Approach*. Clarendon Press, Oxford University Press, Oxford.
2. Bonifazi C., Conti C., Gesano G., *Dinamica demografica e migrazioni nell'area del mediterraneo*, në Gomel G., Roccas M., *Le economie del Mediterraneo*, Banca d'Italia, 2000.
3. S. Sassen, *Migranti, coloni, rifugiati. Dall'emigrazione di massa alla fortezza Europa*, Milano, Feltrinelli, 1999.
4. D. Giubilaro, *L'immigrazione dai Paesi del Maghreb in Europa* in ILO, “I lavoratori immigrati e il loro effetto sul mercato del lavoro in Italia”, Roma, 1997.
5. A. Stocchiero (a cura di), *Dossier politiche migratorie e di cooperazione nel mediterraneo*, CeSPI, Ministria e Punëve të Jashtme, Romë, 26 tetor 2001.
6. A. Germani, *Immigrazione: il modello mediterraneo*, në “Affari sociali internazionali”, n. 4, 2001.
7. A. Corneli, *Flussi migratori illegali e ruolo dei paesi di origine e di transito*, Rubettino, Roma, 2005.
8. D. Bigo e E. Guild, *Le visa: instrument de la mise à distance des « indésirables »*, in « Cultures & Conflits », n° 49, Parigi, l'Harmattan, 2003.
9. R. Adam, *La cooperazione nel campo della giustizia e degli affari interni: da Schengen a Maastricht*, ne “Rivista di diritto europeo”.
10. B. Nascimbene, “L'approccio globale nella gestione dell'immigrazione: la politica UE alla luce dell'attuazione del Programma dell'Aja” në “Diritto dell'Unione Europea”, 2008.
11. G. Elspeth, S. Carrera, *Towards the next phase of the EU'S Area of Freedom, Security and Justice: The European Commission's Proposal for the Stockholm Programme*, CEPS Policy Brief N. 196, Centre for European Policy Studies, gusht 2009.
12. http://www.europarl.europa.eu/aboutparliament/it/displayFtu.html?ftuId=FTU_5.12.3.html
13. Human Rights Watch, *Scacciati e schiacciati*, Human Rights Watch, New York, 2009.
14. <http://www.consilium.europa.eu/uedocs/cmsUpload/031208ESSIIT.pdf>
15. S. Wolff, *La dimension méditerranéenne de la politique Justice et Affaires intérieures*, in « Cultures & Conflits », n. 66, verë 2007.